




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Drejtoria për Shërbime Publike, Ambientit, Inspektoratit dhe Emergjenca
Nr.10/234 datë 26/05 2026

Në bazë të nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe nenit 4 të Statutit të Komunës së Kamenicës, (statuti 01, Nr.20203 datë 21.06.2023), nenit 5 paragrafi 5.1; neni 20 paragrafi 20.2; i Ligjit për rrugët (Ligji Nr.2003/11), si dhe rregullorja për organizimin e brendshëm të Administratës Komunale në Komunën e Kamenicës, si dhe rrezikut që u shkaktohet këmbësorëve nga lëvizjet e pa kontrolluara të skuterëve elektrik dhe biçikletave në bulevardin e qytetit, Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjenca, nxjerr këtë :

V E N D I M

1. Ndalohet qarkullimi i skuterëve elektrik dhe biçikletave në rrugën "Skënderbeu" deri te aksi që lidhet me rrugën "Vëllezërit Bytyqi", përkatësisht në bulevardin e qytetit;
2. Ndalimi i qarkullimit të skuterëve elektrik dhe biçikletave fillon nga data 15.06.2026, prej orës 19:00 h deri në ora 24:00 h;
3. Obligohet DSHPAIE, që në segmentin e rrugës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi të vendoset sinjalizimi përkatës;
4. Vendimi hyn në fuqi nga data 15.06.2026.

A r s y e t i m

Ndalimi i qarkullimit të skuterëve elektrik dhe biçikletave si në pikën 1 të këtij vendimi është marrë për shkak të sigurisë së këmbësorëve ku në këtë periudhë kemi një frekuentim të shtuar të qytetarëve, duke llogaritur edhe ardhjen e qytetarëve tanë nga diaspora, ku kjo pjesë është e dedikuar për lëvizjet të lirë të këmbësorëve-shëtitore.

Vlefshmëria e këtij Vendimi është deri më datën **31.08.2026**.

Vendimi t'i dorëzohet:

- DSHPAIE;
- Policisë së Kosovës, stacioni në Kamenicë;
- Zyrës së Informimit;

